



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR

Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1, Shkodër, web: www.bashkiashkoder.gov.al, e-mail: info@bashkiashkoder.gov.al, Tel: +35522400150

PROCES VERBAL PËR KËSHILLIM ME PUBLIKUN

PËR

**“DRAFTIN E PROJEKT PLANIT BUXHETOR AFATMESËM 2023-2025 TË
BASHKISË SHKODËR”.**

Konsultim publik : *Banorët e Nj. Administrative Dajç.*

Data : 10.10.2022

Ora : 13.00

Vendi: *Nj. Administrative Dajç, Salla e Mbledhjeve*

Numri i pjesëmarrësve : *Numri i pjesëmarrësve 26, nga të cilat 5 gra dhe vajza.*

Titulli i Projekt-aktit që konsultohet : *Per draft projekt planin buxhetor afatmesëm 2023-2025 të Bashkisë Shkodër*

Pjesëmarrës: Drejtues dhe specialistë të administratës së Bashkisë Shkodër dhe banorë (Bashkangjitur liste prezenca).

Takimi bashkë-drejtohet nga Zv.Kryetari i bashkisë dhe përfaqësues të Këshillit Bashkiak të cilët bënë një prezantim të shkurtër në lidhje me :

- ✦ Projekt-aktin e propozuar
- ✦ Shpjegoi qëllimin e konsultimit publik
- ✦ Shtroi pyetjet konkrete për pjesëmarrësit
- ✦ Dha informacion për mënyren e dhënies së rekomandimeve.
- ✦ Ju dha fjalën pjesëmarrësve

Pjesëmarrësit që morën fjalën, diskutuan dhe dhanë rekomandimet përkatëse në lidhje me çështjet që konsultohen janë si vijon :

Fjala përshëndetëse nga zv/kryetari i bashkisë për falenderim pjesëmarrje në konsultimet publike për buxhetin 2023-2025 në bashkëpunim me banorët dhe keshillin bashkiak i cili është autoriteti që merr vendimet pas propozimeve nga ana e banorëve dhe specialistëve të bashkisë.

Erjon Metushi: shkurtimisht u paraqit se ku qendron ideja dhe fokusi i takimit, duam të marrim nga ju nevojat dhe problematikat e zonës , të gjithë kemi dëshirën dhe nevojën për rrugën apo ambjentin personal , por le të marrim idetë dhe propozimet për të gjithë komunitetin. Keto janë nisma që janë organizuar vitet e fundit dhe nga eksperiencia që kemi është faktuar që propozimet tuaja janë marrë dhe megjithese disa nuk jane zbatuar është me rëndesi që ti diskutojmë të gjitha Kemi ardhur për të marrë dëgjuesen tuaj dhe pavarsisht politikës fjala është e juaja.

1- Arsimin baze te mesëm dhe profesional

Ardita Larushku drejtoreshë shkolla “Pjeter Gaci” Shirq, shkolla ka një infrastrukturë të mirë, nuk ka rrezikshmëri dhe gjendja është e mirë në përgjithësi

Kemi bërë një kërkesë të ripërsëritur dhe me gjithë bashkëpunimin dhe mirëkuptimin e drejtorit kemi një projekt që kemi filluar me bashkinë Shkodër dhe këndi sportiv nuk u realizua sipas pritshmërive që kemi pasur.

Hyrja e shkollës është me lagështirë oborri mbushet me ujë dhe është e pamundur të bëjmë orët e edukimit fizik. Mbetet problematike lidhja e oborrit të shkollës me qendrën shëndetsore apo komunitetin

1. Hyrja të jetë e rehabilituar dhe pa ujë.
2. Lyerje efikase e një klasë dhe ambjenteve të tjera problematike për ambjentet e brendshme (jemi me ngrohje me stufa dhe është e nevojshme lyerja e ketyre ambjenteve)
3. Karrige dhe materiale sipas shkresës së dërguar.

Jemi munduar në vite që këtë shkollë të viteve ‘46 duhet të mbahet sipas kushteve dhe të ketë përkujdesje pavarsisht rënies së nr. të nxënësve ne bëjmë punën tonë të përkushtuar.

Janë gjëra të vogla si lyerje e ambjenteve të brendshme etj.

Albina Kulla, shkolla e mesme e bashkuar , falenderojmë për lyerjen e realizuar këtë vit. Do donim:

Ambjenti i jashtëm i shkollës është i pasovatuar dhe ka nevojë të ketë rikualifikim në muret e jashtme të shkollës, sikur edhe me gëlqere, ka që në 1997 që nuk është vënë dorë nga ana e jashtme. Kati i parë i shkollës është pothuajse jashtë funksionit dhe me një investim të vogël mund të kthehen në dy ambjente për nxënësit dhe ambjent për edukimin fizik.

Ka problem me ngrohjen në lidhje me sasinë e druve që na vihet në dispozicion duke qënë se ne bëjmë edhe detyrat dhe orë shtesë në këto klasa kemi nevojë për dru. Na duhen edhe stufa dhe shporetë të rinj 5 – 7 cope .

Kemi oborr te mjaftueshëm por pranë është shembur një ndërtesë e vjetër e cila duhet pastruar dhe të hiqen themelet e saj ku mund të bëhet një kënd sportiv.

Kemi dy fusha të ndërtuara privatisht dhe kemi nevojë për pastrim të themeleve dhe mbetjeve te ndërtesës së vjetër, dhe pse jo investimit më tej për një tabelë basket apo fushe sportive.

Kanali fundor i shkollës është i mbyllur sepse mblidhet lagështira dhe ujrat në fund. Duhet verifikuar dhe gjetur mundësia sepse mund të ndikojë edhe për kullimin e ujit të oborrit. Nevojat për rikonstrukcion të brendshëm nuk mbarojnë, dyer të reja, dritare të reja etj. janë përherë të vlefshme.

Zv. Kryetari - ne kemi parashikuar nje mbështetje sa i përket furnizimit me dru dhe do ti shtojmë nga drute e sekuestruara dhe do verifikojmë kërkesat e tjera.

Ylli Kolaj – me gjithë respektin për drejtoreshat e shkollave, flasim për nevojat e infrastrukturës por duhet të diskutojmë edhe për cilësinë e mësimdhënies dhe asaj që merret në shkollë. Fëmijët në shkollë vijnë për t’u arsimuar dhe cilësia e arsimit dhe edukimi që marrin në shkollë lë për të dëshiruar. Shumë nxënës bëjnë arsimin jashtë Dajçit, me siguri nga halli dhe nga mos pëlqimi për të shkuar në këto shkolla.

Albina Kulla – për dy shkollat që mbuloj as që diskutohet mbi cilësinë e mësimdhënies.

Zv. kryetari – takimi sot nuk mbulon këtë fushë, por ajo që mund të bëjmë ne si bashki është në funksion të ambjenteve dhe rikualifikimit të tyre.

2. Menaxhimi i mbetjeve

Tom Pjetrani - Duhet shtuar frekuenca sepse tani është 2 herë në javë, sidomos gjatë sezonit të verës ku ka shtesë të numrit të popullsisë, duhen shtuar kosha në disa vende që i kemi të identifikuar

Kanto Ducaj – Mali i Gjymtit në fshatin tim është që në prill që koshat nuk janë pastruar, ka pretendim se ka disa pemë dhe nuk ka si kalon makina, ne jemi 4- 5 familje dhe vendi është i ndotur, me nevojë të domosdoshme pastrimi.

3.Shërbimet në komunitet

Lulzim Metalji, kryetari fshatit Mushan - Ndrichiimi në rrugën e re është bërë, kurse tek rruga e Piraniquve akoma nuk është vendosur ndrichiimi.

Gjeto Rroku , Suka Dajc - Ne nuk kemi asnjë ndrighues në fshat, paguajmë paratë por nuk është bërë asnjë investim në ndrighim të kësaj zone të paktën nevojiten 5 – 6 ndrighues pranë fshatit dhe shkollës.

Zv. kryetari – me një projekt të fituar do të kemi mundësinë të zëvendësojmë ndrighimin në qytet dhe ato ndrighues që do të hiqen do të dërgohen në njësi administrative.

Gjon Kalivaci, kryetari i fshatit Pentar - Është bërë një investim por janë pa ndrighim dy fshatra dhe duhet të kemi investim me ndrighues në këto dy fshatra.

Viktor Lakaj, Fshati Samrish - kemi shtruar vetë rrugën në Samrish, 500 metër rrugë është e pakalueshme dhe ka nevojë për investim. Gjithashtu KUZ është inekzistent. Ndrichiimi, ka mbetur investimi që nga koha e tërmetit dhe gjatë gjithë kohës kemi problem me energjinë. Po ashtu uji i

pijshtëm është një rrjet i amortizuar dhe nuk është bërë me vite asnjë investim në këtë rrjet. Kurse përse i përket pastrimit nuk kemi frekuencë të rregullt.

Rruga Samrish i ri ka nevojë për rikualifikim dhe kërkesa që kemi bërë me vite nuk është aprovuar asnjë herë.

Zv. kryetari – do të marrim parasysh të bëjmë investim në këtë fshat. Sa i përket infrastrukturës kurse sa i përket kërkesës për rrjetin energjistik nuk është detyrë dhe përgjegjësi e bashkisë. Sa i përket kërkesave të tjera do të kemi prioritet si bashki ndërhyrjet në fshatin Samrish.

4. Menaxhimi i kanaleve dhe ujitjes

Fshati Mushan – Ujitja është me rënie të lirë dhe mungon kanali. Kemi bllokim nga argjinatura.

Alban Sekja - është një pjesë ku po vepron Bordi i kullimit dhe me përfundimin e punës së tyre nga ana e bashkisë deri në fund të zonës Suka - Dajç janë projektet e planifikuara që mund të investohen.

Nga kërkesat që kemi bërë kemi shumë problem me kanalet e dyta të cilat kanë nevojë për pastrim dhe sistemim, kemi pasur asistencë nga GIZ por ka nevojë akoma për ndërhyrje, jo vetëm për bimët dekorative por edhe për zonat e Dajçit, Mushanit, Darragjatit e Pentarit ka shumë nevojë për ndërhyrje sa i përket ujitjes së këtyre zonave ku tashmë kultivohet edhe grurë.

Zv. kryetari – gjatë rrugës për këtu vërejtëm që pjesa e kanaleve është shumë problem dhe e papunuar.

Tom Pjetrani – po përse përket vaditjes? Kanalet një pjesë janë mbyllur një pjesë janë shkatërruar.

Zv. kryetari – problemi i vaditjes është një problem në vehte që ka nevojë për kosto por mbi të gjitha bashkëpunim të komunitetit. Ajo që premtojmë është që duhet të fillojmë të shtrijmë rrjetin pjesor duke provuar rrjedhjen e lirë. Kryetari ka bërë një kërkesë ndaj Ministres së Bujqësisë me një numër të madh projektesh, të cilat normalisht duhet të investohen nga Ministria e linjës e bujqësisë por ne duhet të bëjmë punën tonë të pastrimit dhe lirimit të tyre.

5. Infrastruktura rrugore

Kryetari fshatit Mushan – janë shtruar 600 metra rrugë por tek rruga e shkollës është e nevojshme të ndërhyhet, projekti është i bërë, ka filluar loti i parë dhe duhet përfunduar.

Rruga e Mllojseve, ka nevojë për ndërhyrje, po ashtu Ura e Kanunit, Ura e Lleshit, aty janë 8 familje që banojnë dhe e gjithë zona kalon në këtë urë për në tokat bujqësore. Rruga ka nevojë për inerte apo mbushje duke qëne se lidh tokat bujqësore.

Edhe Rruga e Gramshit ka 35 shtëpi. As në Malin i Gjymtit nuk kemi rrugë, 10 fëmijë shkolle po të jetë kohë me shi e kanë shumë të vështirë për të shkuar në shkollë.

Mark Kolonia, Kryeplak Shirq - Prioritet i parë për ne është pjesa e rrugës së kishës, prioritet i dytë është rruga për në fshatin Shirq, prioritet 3 rruga e Mirucve që është rrugë e shkurtër. Rruga Palaj gjithashtu ka nevojë për ndërhyrje si dhe rruga për në kishën e Shirqit duhet të ketë vëmendje të veçantë duke qëne se është edhe zonë atraksioni turistik.

Emiljan Livadhi, fshati Suka – ka 8 vite që investimet nga bashkia janë 0 në infrastrukturë arsim, ndriçim etj. Asnjë cakull, asnjë investim në Suka, është diskutuar rruga e vorrezave dhe asnjë gjë nuk është bërë. Në qendrën e fshatit Suka, vorreza janë të komunitetit dhe duhen investuar.

Banor Fshati Pentar – rruga e vorrezave është e paasfaltuar që kur është investuar nga emigrantët asgjë e re nuk është bërë.

Tom Pjetrani - faza e dytë e rrugës Samrish i vjetër ka mbetur e papërfunduar loti I, II.

Ylli Kolaj - Dëmtimi i sinjalistikës rrugore sepse nuk ka tabela për zonën në hyrje të Dajçit, është bërë investim për rrugën e Dajçit dhe duhet investuar sërish në infrastrukturën e sinjalistikës rrugore.

Emiljana Mandi, Punonjëse e Z1N - Kemi përsëritur kërkesat për tre segmente rrugore në Dajç dhe do të ishin ndërhyrje me vlerë edhe në:

1. Rruga e Zallit
2. Rruga e Lisit
3. Rruga e Mandajve

Të cilat janë të domosdoshme për bujqësinë. Gjithashtu duhet rehabilituar argjinatura dhe identifikuar problematikat përpara se të ndodhin përmbytjet, duhet inspektim paraprakisht aty.

Zv. kryetari – pavarësisht se nuk është pjesë e kompetencës tonë ne do ta diskutojmë edhe në Prefekturë dhe autoritetet që janë përgjegjëse.

6. Shërbimi shëndetsor

Drejtori i qendrës shëndetsore Dajç - Kam tre godina në administrim, një në Pentar dhe një në Mushan dhe qendrën shëndetsore Dajç.

Dajçi është në plan të Ministrisë së Shëndetësisë për rikonstrukcion total. Mushani është në gjendje të mirë. Ndërsa ambulanca Pentar ka vite që është në funksion por është në rrezik shëmbjeje, jemi drejtuar edhe bashkisë apo institucioneve përkatëse por pa zgjidhje. Ajo pëson shëmbje si godinë duke rrezikuar jetën e stafit dhe banorëve. Kemi diskutuar edhe me inxhinierët por nuk ka mundësi për rikonstrukcion por duhet godinë e re. Ne humbëm mundësinë e investimit me Katarin nga mungesa e dokumentacionit të pronës. Ka një iniciativë për regjistrim prone por akoma nuk ka asgjë konkrete. Kjo bën të pamundur investimin nga cdo donator apo ministri sepse nqs nuk ka pronësi askush nuk investon. Duhet parë mundësia për pajisje me certificate pronësie.

Zv. kryetari – Ne kemi kryer pjesën tonë si bashki, ia kemi dërguar dokumentacionin hipotekës dhe por akoma nuk është përfunduar procesi.

Drejtori i qendrës shëndetsore, Dajç - Situata realisht është shumë e rëndë dhe stafi mendoj që mos ta lëmë të ofrojë shërbim në këtë godinë. Kemi dy ish klasa të shkollës fillore Samrish i vjetër të cilat mund të kalojnë në administrim të shëndetësisë, dhe kemi rënë dakort që ti kalojnë shërbimit shëndetsor, nuk e di dhe nuk kemi informacion më gjatë për këtë kërkesë. Kjo do të bënte që edhe për banorët edhe për infermierët të jenë pranë komunitetit.

Doktori Besnik Haxhija – për sa i përket ujit të pijshëm të gjithë ujësjellsit në zonë me dijeni time janë jashtë funksioni, pra ujë me cilësi jo të mirë. Nga analizat që bëjme uji është i pakonsumueshem dhe nuk duhet konsumuar duke qënë se tokat e zonës së Dajçit janë të gjitha me nitrata dhe pjesë e lartë e banorëve kanë probleme shëndetsore. Nëse bashkia ka mundësi të ndërhyje në këtë drejtori për të ofruar një shërbim më të mirë. Pra ka nevojë për rikonstruksion apo riparime të rrjetit të ujësjellsit. Ose të afrohen rrjete të reja tubacioni me ujë të pijshëm nga qendra Bërdicë ku uji është i pijshëm.

Erjon Metushi – e fundit për shëndetësinë, duke ditur se sa është buxheti është më mirë që ti japim vemendje kësaj pjese të ujësjellesit, me shumë sesa rruget apo investimet e infrastruktures etj. Prandaj ti jepet vemendje më e madhe kësaj kërkesë.

Edhe sipas një anketimi që ka bere doktori i Dajçit në këtë zonë, sipas kërkesës për kritere është e pamundur të akreditoresh dhe ndihmohesh edhe nga fondet e mbështëtjes së shtetit.

Zv. Kryetari i Bashkisë :

Duke ju falenderuar për opinionet dhe nevojat e paraqitura ju falenderoj sërish dhe shpresojmë që të kemi mundësinë të realizojmë keto propozime të bera sot këtu nga ana juaj.

Pyetje dhe diskutime të tjera nuk ka. Mbledhja deklarohet e mbyllur.

Mbajtësi i Procesverbalit:

Bekim Mema








BASHKIA
SHKODËR

Këshillim me publikun -Për draftin e projektplanit buxhetor afatmesëm 2023-2025.
Nj.Administrative Dajç

NR	EMER	MBIEMER	GJINIA	MOSHA	VENDBANIMI	PROFESIONI	PUNESIMI
1	Bemirota	Gramshi	F	23	Dajç	Informiere	QSH Dajç
2	Xhulio	Dajç	F	28	Dajç	Informiere	QSH Dajç
3	Merisa	Hodunaj	F	50	Dajç	Informiere	QSH Dajç
4	Ylber Xukaj	Xukaj	M	67	-Dajç	Buxhetar	
5	Remond Opera	Opera	M	61	-Dajç	Buxhetar	(ingj)
6	Enon Frol		M	62	Bela	Punëtar	QSH Dajç
7	Blendi	Kolarci	M	55	Pentari	Buxhetar	QSH Dajç
8	Herby Jole	Jole	M	66	Dajç	Buxhetar	QSH Dajç
9	Tamir	Mehmedaj	M	60	Mullkaj	Buxhetar	QSH Dajç
10	Gjermani	Xukaj	M	38	Dajç	Buxhetar	QSH Dajç
11	Hoxhi	Hoxhi	M	38	Samiqi s.l.	Buxhetar	QSH Dajç
12	Hozen	Hoxhi	M	21	Samiqi, Ri	Inspektur	QSH Dajç
13	Radon	Radon	M	67	SHKODË	Buxhetar	QSH Dajç

KOORDINATORI PER KONSULTIMIN PUBLIK



BASHKIA
SHKODËR

Këshillim me publikun - Për draftin e projektplanit buxhetor afatmesëm 2023-2025.
Nj.Administrative Dajç

NR	EMER	MBIEMER	GJINIA	MOSHA	VENDBANIMI	PROFESIONI	PUNESIMI
1	ALBINÉ	KULLA	F	48	SHKODËR	DOKTOR	SH"LUCE"AGRIJA"
2	AKDITA	ÇARUSHI	F	38	SHKODËR	DREJTOR	SHK. Petro Geci, Shing
3	BESNIK	HAXHIA	M	54	SHKODËR	MJEIC FAN	Q. SH-DALJE
4	Gom	Petromi	M	62	SHKODËR	Kryeshtet Fehi	i fa punë
5	Grvin Palaj	f	M	35	SHKODËR	Administrator	Bashkia.
6	Gjeta Roka						
7	BEP	GJURA	M	34	SHKODËR		
8	Abdina Palaj		M	39	Tiranë	Arhitekt	Arhitektbure
9	Alben	Sejdi	M	82	Shkoder	Apresee	B. Shkoder
10	Bobin ymeri		M	74	Prushkull	Pemjor	
11	Kantel Puka		M	61	Nishi Gjymnasti King Jolak		
12	Gëzina Haxhi		M	56	Musha	Kryed. F. Jolak	

KOORDINATORI PER KONSULTIMIN PUBLIK



BASHKIA
SHKODËR

Këshillim me publikun -Për draftin e projektplanit buxhetor afatmesëm 2023-2025.
Nj.Administrative Dajç

NR	EMER	MBIEMER	GJINIA	MOSHA	VENDBANIMI	PROFESIONI	PUNESIMI
1	Vitor	Labez	Mai	47	Jamnikë / Ri	Pensionist	Pensionist

COORDINATORI PER KONSULTIMIN PUBLIK _____